

Në këto kushte, ndryshe nga Gjykata për Krime të Rënda, ky kolegji i gjykatës së apelit cmon që duhet të konfiskohen, duke kaluar në favor të shtetit, apartamenti i banimit me sipërfaqe 121 m^2 , blerë në emër të të paditurës Nekije Gorgeja, objekti lokal me sipërfaqe 174 m^2 , blerë në emër të të paditurës Nekije Gorgeja dhe, depozita e kurssimit në Banken Raiffeisen, në emër të të paditures Nekije Gorgeja. Në këtë vështrim, gjykata e apelit çmon se pretendimet e përfaqësuesit të palës paditëse, janë pjesërisht të drejta, dhe si rrjedhojë bazuar në kërkesat e ligjit procedural civil (neni 466/b i KPC), vendimi nr 09, datë 09.03.2017 të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, duhet të ndryshohet, pikërisht për pasuritë e sipërcituara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, mbështetur në nenin 466/1/ "a" e "b" të K.Pr.Civile,

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit nr.09, dt.09.03.2017 të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, në lidhje me rrëzimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë, ndërtësë 4 katëshe, ndodhur në zonën kadastrale nr. 8517, me numër pasurie 5/32, me sipërfaqe prej $1\,810\text{ m}^2$, nga e cila sipërfaqe ndërtimore $182\text{ m}^2 + 44\text{ m}^2 + 1\,232\text{ m}^2$, në proces legalizimi në emër të shtetasit Skënder Gorgeja;
- Ndryshimin e këtij vendimi si më poshtë:

 1. Konfiskimin e pasurise si me poshtë: Apartament banimi me sipërfaqe 121 m^2 , me numër pasurie 46/184+1-11, vol 31, faqe 160, zona kadastrale 8518, Durrës, rregjistruar në emër të shtetasës Nekije Gorgeja;
 2. Konfiskimin e pasurisë të llojit "lokal", me sipërfaqe 174 m^2 , ndodhur në lagjen nr.1, Rruja: "Taulantia", Durrës me numër pasurie 24/211- N9, zona kadastrale 8512, volumi 35, daqe 176, rregjistruar në emër të shtetasës Nekije Gorgeja;
 3. Depozitë kursimi me afat maturimi datë 07.05.2015 në vlerën 1. 380, 920,45 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet presje dyzet e pesë) lekë, në emër të shtetasës Nekije Gorgeja, pranë "Raiffeisen Bank" Sh.A.

- Ngarkohet zyra e përmbarimit Durrës për ekzekutimin e ketij vendimi.
- Nje kopje e ketij vendimi i dërgohet Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga ky vendim.
- Shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë këtij gjykimi, u ngarkohen të paditurve.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, sipas ligjit. Për palet në mungesë, ky afat fillon nga momenti i komunikimit.
- U shpall në Tiranë, 15.05.2017.

A N Ë T A R E
Albana BOKSI
d.v

A N Ë T A R E
Nertina KOSOVA
d.v

K R Y E S U E S
Gjovalin PËRNOCA
d.v

